



VENDIM

Nr. 94 Datë 26.09.2011

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “KESH” SH.A PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE
PËRKATËSISHT “NENSTACIONI LANABREGAS”; “NENSTACIONI
BOGOVE”; “NENSTACIONI GJANC”; “NENSTACIONI BUSHAT
110/20KV”; “RRJETI 20 KV KOPLIK”; “NENSTACIONI SHKODER
110/20KV”; “NENSTACIONI FIER 110/20KV”; “NENSTACIONI
GJIROKASTER”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licensës “Për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.09.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të asetëve nga shoqëria KESH sh.a tek Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 Emri dhe adresa e plote e të licensuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korekte.)
- Neni 7, pika 1.3, gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, Përshkrimi i të licensuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)
- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)



Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KESH” sh.a, ”Për transferimin e aseteve, përkatësisht të: “Nënstacionit Lanabregas”; “Nënstacionit Bogove”; “Nënstacionit Gjanc”; “Nënstacionit Bushat 110/20kv”; “Rrjetit 20 Kv Koplík”; “Nënstacionit Shkodër 110/20Kv”; “Nënstacionit Fier 110/20Kv”; “Nënstacionit Gjirokastër”, tek CEZ Shpërndarje sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.